



Lane Late



Valencia Olinda



Navelina

KONKLUZIONE

Të gjithë kultivarët e portokalleve të përshkruara më sipër përshtaten mirë në kushtet klimatike dhe tokësore të zonës së Shamogjinit. Nga vëzhgimet e bëra në koleksion sipas metodikës rezultojn si më poshtë:

-Përsa i përket prekjës nga tenja minuese në përgjithësi kultivarët e portokalleve kanë shkallë prekje mesatare, prekje më të lartë ka grupi i portokalleve “Moro” ndërsa prekje më të ulët kanë portokallet “Taroco Gallo”.

Ndaj breshkëzës kanë prekje të lartë kultivarët “Moro Nuc”/Troyer, Navelina VCR Pal/carizo, “Navelina “/Carizo, W .Navel Ces 3093.

Duke ju referuar analizave kimike rezultojn me perqindje më të lartë sheqeri kultivarët : Navelina VCR pal 8-25-76/ Nerënx, Navelina S/A 3/5 /Nerënx, Taroco Scire VCR Troyer, Taroco Nuc 67-16-1/Citrumelo, Taroco, Taroco Nuc/Nerënx.

Me aciditet të ulët përmendim kultivarët : Navelina/ Nerënx, Navelina VCR Pal/Nerënx, Navelina S/A 3/5 /Nerënx, Navelina VCR pal 8-25-76/ Nerënx. Përmbajtja e vitaminës C është më e lartë në kultivarët e Tarocos në përgjithësi e cila varion nga 32-45ml/100gr si dhe Navelina nga 29-32ml/100gr.

REKOMANDIME

Duke parë rezultatet e këtij studimi ne jemi të gatshëm të orientojmë fermerët të cilët janë të interesuar që të krijojnë agrumishte të reja drejtë kultivarëve më të mirë, por edhe fidanaprodhuesit e agrumeve për të marrë material bimor për shtim nga kultivarë të rinj nga me të mirët ne tregun Italian por të përshtatur edhe në kushtet e vendit tonë dhe konkretisht në zonen e Vlores

QENDRA E TRANSFERIMIT TE TEKNOLOGJIVE BUJQESORE VLORE

Studime në germoplazmën e agrumeve mbi përshtatshmërinë e tyre ndaj kushteve biotike dhe abiotike të Shamogjinit



Kjo fletë palosje është hartuar Per njohjen nga fermeret me përshtatshmerine e kultivareve te portokalles mbjelle ne koleksionin e Shamogjinit ne kushtet e zones se Vlores

Lidalazaj@yahoo.com
TEL 0693699292

te

Në vitin 2009 në Bazën eksperimentale Shamogjin u ngrit koleksioni i agrumeve ardhur nga Italia me tre specie Manderina, Portokall dhe Limon me një numër të madh kultivarësh.

Pas shtatë vitesh është e nevojshme të bëhet studimi agrobiologjik i kultivarëve dhe të shihet përshtatshmëria e tyre në kushtet ambjetale të zonës tonë.

Qëllimi : Të promovojmë kultivarët më të mire dhe t'ua rekomandojmë fermërve si dhe ti furnizojmë ata me material shumezues cilësor.

Koha e zbatimit : Janar- dhjetor 2016.

Metodika e përdorur:

Ne studim u përfshin 18 kultivarët kryesor të portokalleve mbi nënshartesa të ndryshme sipas tabelës më poshtë.

Treguesit që u morën në studim:

Fenofazat: gonxhimi dhe lulëzimi, fillimi dhe përfundimi i tyre.

Analizat fizike të frutit: Peshë e frutit, raporti tul-lëvore, diametri gjatsor dhe tërthor i frutit, sasia e lëngut dhe numri i farave në frut.

Analiza kimike të frutit: Lënda e thatë, % e sheqerit, aciditeti, Ph, vitamina C.

:



Taroco Gallo VCR Pal



Moro Nuc 58-8-D-1



Navelina VCR Pal




Taroco IAM-UBA



Navelina VCR Pal 8-25-7-2



Taroco Scire VCR



Taroco Nuc 67-16-1



Navelina S/A 3/5



Taroco